

AKT THEMELIMI

I SHOOËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**“BIBA – AL KONSTRUKSION ” SHPK**

Sot më datë 15.05.2019 ne shtetasit :

- **Age Ndue Biba** e datëlindjes 15.07.1971, e lindur në Rrëshen dhe banues në Rrëshen, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.personal H15715106H, me cilësinë e ortakut themelues ;
- **Elidon Aleksandër Biba**, i datëlindjes 27.05.1995, i lindur në Rrëshen dhe banues në Rrëshen , madhor e me zotësi juridike të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit Id me nr.personal J50527044R, me cilësinë e ortakut themelues ;
- **Sorgena Aleksandër Biba**, e datëlindjes 12.08.1997, lindur në Rrëshen, banuese në Tiranë, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.personal J75812035K, me cilësinë e ortakut themelues ;

kemi redaktuar këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarojmë se me vullnet të lire të plotë dhe iniciativen e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “ Për shoqërite tregtare ” në ligjin “ Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, vendosëm të krijoj shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, **“BIBA – AL KONSTRUKSION ” SHPK.**

Neni 1

Krijimi

Shoqëria

**“BIBA – AL KONSTRUKSION ” SHPK**, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (këtu e më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **“BIBA – AL KONSTRUKSION ” SHPK**, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në Adresën:



Rruga Rrëshen – Kolsh ,Nr pasurie 112-ND, Lagjia “Kolsh” ndertese dykatëshe nr 33 ,  
Zona Kadastrale 1666 Rreshen, Mirdite.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

#### Neni 4

##### Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit të biznesit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### Neni 5

##### Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

*Aktivitet në fushën e ndertimit si: Ndërtim rrugësh, ujësjellësa, kanalizime të të gjitha kategorive. Ndërtim i digave, tuneleve dhe veprave të artit, ura dhe hidrocentrale të të gjitha kategorive. Ndërtime dhe restaurime të objekteve civile – industriale – turistike, porte, aeroporte, gazsjellës etj. Gjithashtu shoqëria do të ketë si objekt veprimtarie: prodhimin dhe tregtimin e materialeve të ndërtimit, inerte, blloqe tubacione, soleta të parafabrikuara etj. Import – export dhe tregtim të makinerive, pajisjeve, pjesë këmbimi mallra industriale etj. Shoqëria do të kryejë edhe çdo veprimtari tjetër ligjore që ka lidhje me objektet e mësipërme të veprimtarisë.*

#### Neni 6

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe është i ndarë në 3 kuota, vlera nominale e të cilave janë:

- Age Biba, 1 kuote me vlerë nominale 34.000 (tridhjetë e katër mije) lekë;
- Elidon Biba, 1 kuotë me vlerë nominale 33.000 (tridhjetë e tre mije) lekë;
- Sorgena Biba, 1 kuotë me vlerë nominale 33.000 (tridhjetë e tre mije) lekë;

të zotëruara nga ortakët e shoqërisë, kuota këto me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë) Lekë të cilat përbëjnë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

#### Neni 7

##### Organi Vendimmarrës

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e ortakëve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së

vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët, të cilët mund të përfaqësohen edhe nga një tjetër person, nëpërmjet prokurës.

Administratorët – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Neni 8  
Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e ortakëve.  
Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB –së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 9  
Administrimi

Administratorët emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë. Asambleja e ortakëve vendos për sistemin e administrimit, dhe në rastin e një organi administrativ me shumë administratorë, përcakton numrin e tyre dhe kompetencat. Administratori/rët, mund të jenë ose jo ortakë. Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë. Administrator i shoqërisë është Elidon Biba, për një periudhë 5 vjeçare sipas ligjit.

Neni 10


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.  
Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare".  
Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë që ka lidhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 11  
Dispozita përfundimtare


Ky akt themelimi pasi u redaktua dhe lexua nga ortaku i vetëm themelues, miratohet në parim dhe nen per nen nga ortaku i vetëm themelues i shoqërisë tregtare dhe nënshkruhet prej tij.

ORTAKËT THEMELUES

**Elidon BIBA**



**Age BIBA**



**Sorgena BIBA**

